



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_

**PROCESVERBAL**

**Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të  
Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

**Tiranë, 30 maj 2018**

Më datë 30 maj 2018 u zhvillua një takim pune me anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), i cili u mbajt pranë ambjenteve të “Shtëpisë së Evropës” – Tiranë.

Tema e takimit:

1. Vlerësimi i çështjeve të ngritura
2. Përcaktimi i vazhdimësisë dhe i hapave konkrete që duhet të ndërmerren

**Në takim marrin pjesë:**

1. Z. Blendi Dibra
2. Znj. Zana Vokopola
3. Z. Vladimir Thanó
4. Znj. Arta Dyrmishi
5. Z. Ali Coka
6. Znj. Emanuela Zaimi

**Përfaqësues nga AMSHC:**

1. Znj. Mimoza Çorbaxhi
2. Z. Andi Luga

Takimi hapet në orën 14:20 nga z. Blendi Dibra, Zv/Kryetar i KKSHC-së, i cili solli në vëmendje punën e bërë dhe rezultatet e arritura lidhur me çështje që e shqetësojnë sektorin e shoqërisë civile dhe që janë ngritur si shqetësim në çdo takim të organizuar, si rimbursimi i TVSH –së dhe problemi i regjistrimit të OJF-ve.

Z. Dibra gjatë fjalës së tij theksoi:

“Shumë nga ne janë investuar vërtet duke i shërbyer Këshillit dhe rrjedhimisht sektorit që përfaqësojmë. Kemi punuar shumë me Udhërrëfyesin (RoadMap), kjo falë dhe ndihmës së Asistencës së BE-së. Jemi në pritje të RoadMap-it të rishikuar dhe Planit të veprimit për të planifikuar axhendën tonë të mëtejshme. Vlen të theksoj se kemi pasur dhe një bashkëpunim të mirë me AMSHC-në në rolin e Sekretariatit si dhe me agjenci të tjera të huaja që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë si UNDP, OSCE etj., të cilat kanë kërkuar që ne të jemi prezent në takime të organizuara prej tyre dhe të forcohen lidhjet dhe bashkëpunimi. Më vjen mirë që në prezantimin e Raportit për Shqipërinë ishte përmendur progresi i bërë në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, por është theksuar, se tani e tutje, ç’mund të bëjmë për monitorimin e të gjitha veprimeve dhe masave për zbatimin e Udhërrëfyesit.”.

Znj. Vokopola thotë: “Jam ftuar në takimin e datës 8 qershor 2018 nga Kryeministria dhe unë mund të prezantoj diçka në lidhje me punën tonë të deritanishme.”.

Ajo gjithashtu thekson:

“Objektivat e mijëvjeçarit të ri të Kombeve të Bashkuara janë shumë madhore dhe të përgjithshme pasi ato janë vendosur për mbarë botën, si p.sh. zhdukja e malaries apo dhe e varfërisë, por ne duhet të përqëndrohemi te gjërat që lidhen me ne. Në takimin që kemi pasur me Brian janë thënë shumë gjëra, por ne duhet të përqëndrohemi në disa probleme që lidhen me vendin dhe shoqërinë tonë. Unë mund të them që Këshilli ka dhënë kontribut në organizimin e takimeve rajonale me Shoqërinë Civile të organizuara në bashkëpunim me AMSHC-në dhe Asistencën e BE-së për diskutimin e prioriteteve të RoadMap-it dhe çështjeve të tjera që shqetësojnë sektorin. Një rëndësi të veçantë, ku ne duhet të përqëndrojmë punën është dhe bashkëpunimi me pushtetin lokal, i cili deri tani ka qenë në nivele jo të kënaqshme. Dhe së treti duhet të futemi në një projekt konkret.”

Z. Coka thotë se dhe problemi i malaries duhet parë si shqetësim pasi nga një studim i tij ka zona kënetore dhe me probleme.

Znj. Vokopola thekson përsëri: “Objektivat e OKB-së janë shumë të përgjithshme, ne duhet të përqëndrohemi tek tonat.”

Më tej znj. Vokopola propozon se Këshilli duhet të dalë me një deklaratë në lidhje me Objektivat e OKB-së dhe se duhet të jetë me natyrë të përgjithshme se sa i mbështesim ne këto objektiva të Mileniumit të Ri.

Znj. Dyrmishi thekson: “Ne punojmë shumë, e dimë punën e njeri – tjetrit, por duhet bërë shumë për ta bërë këtë punë të dukshme dhe të prekshme në komunitet dhe në OJF-të që përfaqësojmë. Si do ta tregojmë veten tonë që kemi punuar.”

Ndërhyn z. Dibra duke thënë: “Ne zyrtarisht kemi filluar të funksionojmë nga 27 dhjetor 2017. Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa takime me shoqërinë civile, janë dhënë formularë për t’u plotësuar në lidhje me Udhërrëfyesin dhe po plotësohen, është punuar për TVSH-në dhe për ndryshimet në ligjin për regjistrimin e OJF-ve. Mos harro se falë shumë përpjekjeve dhe punës tonë të madhe tani kemi arritur të futemi në axhendën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për problemin e taksave, TVSH-së, regjistrimit etj. Sot na u premtua se do të miratohet Udhërrëfyesi i Ri, pra jemi pjesë e suksesit.”

Z. Thanó merr fjalën dhe thekson: “Ne si Këshill duhet të gjenerojmë aktivitete dhe këto aktivitete duhet të dalin nga plani i punës së Këshillit.”

Znj. Dyrmishi shprehet se duhet të llobojmë dhe duhet të bëjmë të ditur se çfarë kemi bërë deri tani dhe cilat janë planet për të ardhmen.

Z. Dibra shprehet: “Duhet të demonstrojmë se jemi të gatshëm të kontribuojmë, të besojmë se me punë e përkushtim do të zgjidhen problemet që kemi. Duhet të pranojmë se dhe ne kemi dobësitë tona.”

Më tej, z. Dibra propozon që mbledhja zyrtare e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile të mbahet në një nga datat 18, 19 ose 20 qershor 2018. Të pranishmit bien dakord në parim për datën 18 qershor 2018.

Gjithashtu u propozuan dhe u ra dakord edhe për çështjet që do të trajtohen që janë:

- Prezantimi i Udhërrëfyesit të rishikuar
- Prezantimi i kalendarit të aktiviteteve, planifikimi i një konference kombëtare
- Kërkim informacioni nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë se çfarë është bërë në lidhje me TVSH-në
- Prezantim i punës së bërë nga komitetet e ngritura brenda Këshillit
- Hartimi i një Rregullore të Brendshme dhe Plan Komunikimi për ta bërë sa më vizibël punën e Këshillit
- Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Takimi u mbyll në orën 15:20.